



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 177 prot.

Kamëz, më 09 . 12 .2022

V E N D I M
Nr. 134 Datë 09/12 2022
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE, POSEDUES TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA, BULEVARDI I RI, SHKOZË PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN, TË CILËT PËRFITOJNË SUBVENCIONIM TË QIRASË SIPAS PARASHIKIMEVE TË VKM NR. 409, DATË 15.06.2022 “PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 09.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.134 Datë 09.12.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me nr.7787 prot, datë 21.07.2022 dhe Bashkisë Kamëz me nr.6609 prot, datë 21.07.2022 “Për trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga zbatimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.609, prot, datë 15.08.2022 “Për ngritjen e komisionit të posaçme për trajtimin e kërkesave të poseduesve të ndërtimeve pa leje që preken nga realizimi i projektit Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Shkozë”; Vendimi i Këshillit Bashkiak Kamëz me nr.92, datë 19.07.2022 “Mbi miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”; VKB nr.99, datë 27.07.2022 “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”; Miratimin e listës së subjekteve përfitues për bonus qiraje për familjet që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”.
Këshilli Bashkiak Kamëz”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I:

1. Miratimin e subjektit përfitues do të trajtohen në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrveshjes dhe lëshimit të godinës së banimit duke zbatuar nivelin e qirasë për frymë sipas vendimit të *Këshillit Bashkiak nr.92, datë 19.07.2022 "Mbi miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan"*.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Posaçëm i referuar si më poshtë.

Lista e subjekteve të cilët përfitojnë trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë paraqitet në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI



SUBJEKTET PËRFTTUESE

Nr.	Emër	Mbiemër
1	Artan	Barçi
2	Skënder	Tobli
3	Ylber	Tobli
4	Kastriot	Tobli
5	Bukurije	Tobli
6	Rezart	Tobli
7	Ferdese	Kupa

KRYETAR KESHILLI
HYSENTKOLDASHI

